

V E N D I M
"PËR SEKUESTRIM PRANË BANKAVE"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e perbërë nga:

GJYQTARI ALTIN SHKURTI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Natasha Azemaj**, në Tiranë sot me datë 16/09/2014, mori në shqyrtim materialin procedures që i përket:

KËRKUES: PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, përfaqësuar nga prokurorja Antoneta Sevdari

OBJEKTI: Sekuestrim i Llogarive Bankare

BAZA LIGJORE: Neni 210 i K.Pr.Penale

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit për sekuestrimin e llogarive bankare dhe bisedoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal Nr. 6381 të vitit 2014.

Gjatë seancë gjyqësore rezultoi se:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rregjistruar procedimin penal nr.6381 të vitit 2014 për veprën penale të “ Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga nenei 287 i i Kodit penal. Ky procedim penal është rregjistruar mbi bazën e informacionit të referimit të dërguar nga sektori per Krimin Ekonomik dhe Financiar prane Drejtorise se Policise se Qarkut Tirane. Në informacionin e referimit parashtrohet fakti se shtetasi K.I ka investuar shuma të mëdha parash ne pasuri të paluajhtëshme, për të cilat ka dyshime se vijnë nga aktivitete të paligjshme kriminale. Më konkretisht nga të dhënat rezulton se: Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar disponon informacion në lidhje me aktivitetin e kryer nga shtetasi K.I dhe shoqëria Adriatic Development Corporation LTD”, të cilat konsistojnë në faktet se:

Shoqërisë “Adriatic Development Corporation LTD” në periudhën 2006-mars 2008 në Bankën Emporiki (sot Credit Agricole) kishte përfutuar transferta në mbërritje në shumën totale 4.598.501 USD dhe 800.000 EUR.

Pjesa më e madhe e këtyre fondeve ishte dërguar nga shoqëria “Hassans Client2ACC“, me adresë “57/63 Line Eoll Road, NeëYork, USA”, në shumën totale 4.526.228 USD dhe 800.000 EUR.

Përveç dërguesit të mësipërm transfertat ishin dërguar edhe nga United Recouces Ag, ST. Gallerstrasse 19, Zvicer dhe DOMINICUS Ag, ST. Gallerstrasse 19, po në Zvicer.

Një pjesë të fondeve të përfituara në emër të shoqërisë “Adriatic Development Corporation Ltd“, në një total prej 2.994.376 USD, K.I i kishte transferuar të strukturuar në shuma të ndryshme, ku si përfitues ishin kompani dhe persona të ndryshëm në shtete të ndryshme të njohura si parajsë fiskale.

Nga informacioni paraprak rezulton se përshkrimet në këto transferta ishin të ndryshme si: pagesa për studime fizibiliteti në projekte minierash; për shërbime ligjore; për shpenzime zyre; për konsulencë; për shpenzime udhëtimi, pagesa për numra telefonash, etj.

Drjetoria e Policise e Qarkut Tirane dipsonon informacione të marra në rrugë operative se të ardhurat për shoqërite në emer të K.I janë zero”0”.

Sipas informacioneve të marra në rrugë operative nga Drejtoria kundër pastrimit të parave, shoqëria “Hassans Client 2ACC” rezultonte të jetë raportuar në USA për aktivitet të dyshimte në lidhje me transaksione në vlera të konsiderueshme. Në informacionin e referimit gjithashtu theksohet se nga llogaritë e sipërcituara janë kryer transferta dalëse në favor të disa shoqërive dhe individëve me adresa në vende të njohura si parajsë fiskale.

Pra llogaritë në emër të një shoqërie tregtare e cila nuk ka përdorime fondesh brenda Shqipërisë megjithëse është subjekt i regjistruar në baze të legjislacionit shqiptar janë përdorur si koperture për të xhiruar paratë e përfituara nga jashtë për tu ritransferuar në vende, banka dhe destinacione të ndryshme po jashtë Shqipërisë.

Gjithashtu edhe shoqëria Debt International Advisory, sipas informacionit të dërguar Nga Drejtoria Kundër pastrimit të parave, është e dyshuar dhe nën hetim në lidhje me transaksionet në vlera të konsiderueshme të kryera në llogari të saj.

Nga sa më sipër linden dyshime në lidhje me burimin e fondeve dhe aktivitetin e kryer. Nga informacionet që kanë ardhur rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka vendosur bllokimin e përkohshëm të llogarive në Bankën Credit Agricole.

Për sa më sipër egzistojnë dyshime se paratë e ndodhura në llogaritë e shoqërisë “Adriatic Development Corporation LTD” me numër nipti K 71319002 B dhe K.I i dtl (.....), kanë lidhje me një veprimtari të paligjshme kriminale.

Nga paarshtimi i faktit rezulton se plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 210 të K.Pr.Penale për ven dosjen e sekuestros mbi llogarie bankare të shoqërisë “Adriatic Development Corporation LTD” me numër nipti K 71319002 B, pranë CREDIT AGRICOLE BANK dhe shtetasit K.I, pranë CREDIT AGRICOLE BANK;

PËR KËTO ARSYE

Gjykata duke u bazuar në nenet 210 të K.Pr.Penale

VENDOSI

- Sekuestrimin e parave të ndodhura në llogaritë e shoqërisë “Adriatic Development Corporation LTD” me numër nipti K 71319002 B, në CREDIT AGRICOLE BANK .

- Sekuestrimin e parave të ndodhura në llogaritë e shtetasit K.I, pranë CREDIT AGRICOLE BANK;

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas ligjit.

-U shpall në Tiranë sot me datë 16.09.2014 ora 15³⁰

SEKRETARE

GJYQTARI

NATASHA AZEMAJ

ALTIN SHKURTI